



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 5952 Prot

Shkodër, më 13.03.2025

VENDIM

Nr. 103 datë 13/03/2025

“PËR DELEGIM KOMPETENCE”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligjit nr.44/2015 “Kodi Procedurave Administrative Republikës së Shqipërisë”; ligjit nr.9936 ,datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; ligjit Nr.10 296, datë 08.07.2010 ”Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”; ligjit nr.89 datë.22.12.2022 “Për Policinë Bashkiake”; ligjit nr.114/2015 “Për auditin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar; Udhezimi nr.30/2011 “Për menaxhimin e aktiveve ne njesite e sektorit publik” të ndryshuar;

VENDOSA:

1. Shfuqizimin e vendimit nr.755, datë 31.12.2024.
2. Delegimin e kompetencave të Kryetarit të bashkisë Shkodër, z.Alban Preka me detyrë zëvendeskryetar bashkisë Shkodër;
 - për firmosje si nëpunës autorizues.
 - për firmosje si titullar i autoritetit kontraktor për të gjitha procedurat e prokurimit publik.për të gjithë administratën bashkisë Shkodër.
 - për firmosje shkresore që ka të bëjë me institucionet publike, personat juridik/ fizik dhe individ, për të gjitha drejtorite duke përjashtuar strukturat e deleguar sipas vendimit nr.753,datë 31.12.2024, nr.754,datë 31.12.2024.
3. Zv/Kryetari nuk mund t’i nëndelegojë këto kompetenca zyrtarëve të tjerë.
4. Kompetencat e deleguara do të ushtrohen duke filluar nga data 17.03.2025 dhe përfundojnë me datë 30.06.2025, ora 16.00.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet z.Alban Preka dhe administrata bashkisë Shkodër.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen WEB të bashkisë Shkodër.

KRYETAR

~~Bea BSCI~~

